

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Ilirjana Hoti, si dhe me zyrtarin ligjor Flutura Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.R., nga Gjakova, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti-Përgjithshëm në Gjakovë, PP.II.nr.26/19 të dt.29.01.19, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt.**08.08.2019**, murr ketë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP.II.nr. PP.II.nr.26/19 të dt.29.01.19 dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

B.R., i biri i I. dhe nenës F. e gjinisë T., data e lindjes..., në Gjakovë, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i pamartuar shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, numer personal...

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

- **me dt. 27.11.2018 në ora 05:11 min**, në rrugën "Gj.N.K.", në Gjakovë, dëmton pasurinë e personit tjetër ku ka shkuar me një biçikletë dhe më pas me një guri ka thyer xhamin e dyqanit Mobile Shop "E.", pronë e të dëmtuarit Gj.D., me të cilin ditë më parë kishte pasur mosmarrëveshje, me çka me këtë veprim i njëjti në mënyrë të kundërligjshme ka kryer veprën penale dëmtim apo asgjësim i pasurisë.

-me çka ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 4,41,43, 46,73 dhe nenit 333 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 495 të KPPK-së, të akuzuarin B.R. , e

G J Y K O N

Dënimin me gjobë në shumë prej **200.00 € (dyqind euro)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi - Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarimit me dhunë .

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 39 të KPK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 49 par.4 të KPPK-së, do

ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20,00 € (njëzet) euro**.

I dëmtuari Gj.D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00 euro**, e këtë në afat prej **15 ditësh** pasi që Aktgjykimi-urdhri ndëshkimor të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbashtimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP.II.nr.26/19 të dt.29.01.19, ndaj të akuzuarit B.R., nga Gjakova, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së.

Komfor nenit 493 të KPPK-së, PTH në Gjakovë, kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënimi me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së nenit 333 par.1 të KPRK-së, e cila dispozitë për kryesit e kësaj veprë penale parasheh dënim me burgim dE. në 1 (një) vit.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-së dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –se në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- kallëzimi penal me nr.2018-EA-...m të dt.21.12.2018,
- deklarata e të dëmtuarit Gj.D. të dhënë në Policin e dt.27.11.2018
- deklarata e të dyshuarit B.R. dhënë në st. policor me dt. 11.12.2018zj
- raporti i oficerit V.G., PK ..., të dt.27.11.2018,
- raporti fillestar i incidentit me nr...., të dt.27.11.2018,
- foto-dokumentacioni, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë,

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes të veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPRK-së në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform nenit 450 par.2 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.94/19, të dt.08.08.2019

Sekretarja Juridike
Flutura Nagavci

Gjyqtarja
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës të kësaj Gjykate. Nëse i pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.